



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 231 Prot.

Tiranë, më 6 / 2 /2017

VENDIM

Nr. 11, datë 6 / 2 /2017

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi/Komiteti Shqiptar i Helsinkit, përfaqësuar nga Znj. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën nr. 1488 Prot., datë 15.12.2016, ndaj Autoritetit Publik/ Ministrisë së Financave objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumentave zyrtare".

Ankuesi në cilësinë e kërkuesit, me shkresën nr. 504-504/2, datë 27.10.2016 ka kërkuar nga Ministria e Financave t'i vihet në dispozicion informacioni dhe dokumentacioni i disponueshëm si më poshtë vijon:

- a) Nëse institucioni juaj ka hartuar planin vjetor që lidhet me procesin e vendimmarrjes të vitit 2015 dhe 2016, hazuar në nenin 6, pika 1, gërma "b" e Ligjit Nr.146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik". Nëse po lutemi të na përcillni kopje të këtyre planeve.
- b) Cilat janë format dhe mënyrat me anë të të cilave janë bërë publike këto plane vjetore? Nëse publikimi është bërë gjithashtu me anë të internetit, lutemi të na përcillni adresën ndërlidhëse (linkun përkatës).
- c) Listën e projekt-akteve (projektligje, projekt strategji, politika me interes të lartë publik) që janë përfunduar së hartuari nga institucioni juaj brenda periudhës Janar – Tetor 2016. Cilat nga këto projekt-akte i janë nënshtruar procesit të njoftimit dhe konsultimit publik? Për ato projektakte që nuk i janë nënshtruar këtij procesi, lutemi të na informoni mbi arsyet përkatëse.
- d) Kopje të njoftimeve publike për procesin e konsultimit publik që janë bërë për secilin projekt – akt që i është nënshtruar këtij procesi sipas nenit 6/a dhe 11/1 të Ligjit Nr.146/2014, si dhe kopje të njoftimeve për konsultime të drejtpërdrejta dhe takime publike me palët e interesuara sipas nenit 6, pika 2 e këtij ligji, për periudhën Janar-Tetor 2016.
- e) Kopje të ftesave, axhendave, listë prezencave dhe procesverbaleve të mbajtura në takimet publike të organizuara për konsultimin publik për secilin projektligj /projektstrategji/ projektpolitike sipas nenit 18 të ligjit Nr.146/2014, për periudhën Janar-Tetor 2016.

- f) Kopje të përmbledhjeve të rekomandimeve të pranuar dhe arsyeve të mospranimit të rekomandimeve për çdo projekt akt që i është nënshtruar procesit të konsultimit gjatë periudhës Janar-Tetor 2016 sipas nenit 19, pika 3 të Ligjit Nr.146/2014.
- g) Kopje të raportit të transparencës për procesin vendimmarrës të institucionit tuaj për vitin 2015 dhe linkun ku këto raporte janë publikuar sipas nenit 20 të Ligjit Nr.146/2014.
- h) Informacion lidhur me ankesat e palëve të interesuara për cënim të së drejtës për njoftim dhe konsultim publik dhe ecurinë e shqyrtimit të tyre nga Institucioni Juaj, sipas nenit 21 të ligjit Nr.146/2014, për periudhën Janar-Tetor 2016.

Me shkresën nr.14985/1 Prot., datë 15.11.2016, Autoriteti Publik ka informuar kërkuesin lidhur me: "...aktet e miratuara nga ana e Ministrisë së Financave, për periudhën Janar Tetor 2016, të cilat i janë nënshtruar procesit të njoftimit dhe konsultimit publik të parashikuar në Ligjin 146/2014, për projektligjet që janë ende në fazë konsultimi, duke cituar linkun ku gjenden njoftimet publike për procesin e konsultimit publik për projektaktet e iniciuara nga ministria, linkun ku janë publikuar planet vjetore që lidhen me procesin e vendimmarrjes për vitin 2015-2016, kopje të njoftimeve publike për procesin e konsultimit publik që janë bërë për secilin projekt – akt që i është nënshtruar këtij procesi sipas nenit 6/a dhe 11/1 të Ligjit Nr.146/2014, si dhe kopje të njoftimeve për konsultime të drejtpërdrejta dhe takime publike me palët e interesuara sipas nenit 6, pika 2 e këtij ligji, për periudhën Janar-Tetor 2016, kopje të ftesave, axhendave, listë prezencave dhe procesverbaleve të mbajtura në takimet publike të organizuara për konsultimin publik për secilin projektligj /projektstrategji/ projektpolitike sipas nenit 18 të ligjit Nr.146/2014, për periudhën Janar-Tetor 2016, kopje të përmbledhjeve të rekomandimeve të pranuar dhe arsyeve të mospranimit të rekomandimeve për çdo projekt akt që i është nënshtruar procesit të konsultimit gjatë periudhës Janar-Tetor 2016 sipas nenit 19, pika 3 të Ligjit Nr.146/2014. Ndërsa lidhur me informacionin për ankesat e palëve të interesuara për cënim të së drejtës për njoftim dhe konsultim publik dhe ecurinë e shqyrtimit të tyre nga sipas nenit 21 të ligjit Nr.146/2014, për periudhën Janar-Tetor 2016, autoriteti publik ka informuar kërkuesin se nuk ka patur ankesa. Për dokumentacionin që lidhet me kopje të raportit të transparencës për procesin vendimmarrës të institucionit tuaj për vitin 2015 dhe linkun ku këto raporte janë publikuar sipas nenit 20 të Ligjit Nr.146/2014, autoriteti publik nuk ka vënë në dispozicion të kërkuesit një kopje të këtij raporti.

Pas përgjigjes së dhënë nga Autoriteti Publik/Ministria e Financave, ankuesi pretendon se është cënuar në të drejtën për informim, pasi nuk është informuar lidhur me sa ka kërkuar dhe për këtë arsye ka depozituar ankim pranë Zyrës së Komisionerit. Në këto kushte ankuesi kërkon nga KDIMDP, ushtrimin e kompetencave që ju njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit si dhe urdhërimin e dhënies së informacionit/dokumentacionit nga autoriteti publik.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri me qëllim marrjen e një vendimi sa më objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" në të cilin citohet se "Me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personalekur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve", vlerësoi zhvillimin e një seance dëgjimore përpara marrjes së vendimit përfundimtar.

Me shkresën nr. 20/19Prot., datë 05.01.2017, Zyra e Komisionerit njoftoi palët në një seancë dëgjimore në datën 16.01.2017. Në seancën dëgjimore u paraqitën pala ankuese dhe përfaqësuesit e Autoritetit Publik dhe paraqitën qëndrimet e tyre lidhur me rastin, duke rikonfirmuar qëndrimet e tyre të reflektuara në aktet shkresore të trajtuara më sipër.

Pas shqyrtimit të ankesës, si dhe pas konsultimit të legjislacionit përkatës rezulton se informacioni i kërkuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, informacion i administruar nga Autoriteti Publik/Ministria e Financave, është vendosur pjesërisht në dispozicion të kërkuarit. Nga administrimi i provave, rezulton se informacioni i kërkuar në pikat a), b), c), d), e) f) dhe h) të shkresës nr. 504-504/2, datë 27.10.2016, është vënë në dispozicion të kërkuarit ndërsa informacioni i kërkuar në pikën g) nuk është vënë në dispozicion.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, dokumentacioni i kërkuar përbën informacion publik në kuptim të pikës 2, të nenit 2, të Ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", "*informacion publik konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik*" dhe si i tillë, duhet vendosur në dispozicion të kërkuarit Komiteti Shqiptar i Helsinkit, nëse ky informacion disponohet nga Autoriteti Publik.

Theksojmë, se e drejta për t'u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e Komitetit Shqiptar të Helsinkit, përfaqësuar nga Znj. _____, ndaj Autoritetit Publik/Ministria e Financave, Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b), c) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëve shjeve administrative",

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së Komitetit Shqiptar të Helsinkit, përfaqësuar nga Znj. _____, nr. 1488Prot., datë 15.12.2016, ndaj Autoritetit Publik/ Ministrisë së Financave, me objekt "*Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare*".
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik/Ministrisë së Financave, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar në pikën g) të shkresës nr. 504-504/2, datë 27.10.2016, brenda datës 13 . 2 .2017.
3. Rrëzimin e ankesës për pikat a), b), c), d), e), f) dhe h) të shkresës nr. 504-504/2, datë 27.10.2016
4. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.
5. Ky vendim u dha sot në datë 6 . 2 .2017.

